



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

RAPORT VJETOR I VEPRIMTARISË

TIRANË, 2020

PËRMBAJTJA

1.QËLLIMI.....	FAQE 2
2.OBJEKTIVI... ..	FAQE 2
3.PËRMBLEDHJE	FAQE 2
4.ORGANIZIMI DHE METODOLOGJIA... ..	FAQE 5
5.AKTIVITETE TRAJNUESE-ADMINISTRATA TATIMORE	FAQE 6-22
6. AKTIVITETE TRAJNUESE-ADMINISTRATA DOGANORE.....	FAQE 22-35
7.TRAJNIMET – STATISTIKA TË PËRMBLEDHURA... ..	FAQE 36-50
8.AKTIVITETE TË TJERA TË QTATD... ..	FAQE 50-54

1. QËLLIMI:

Arritja e objektivave të institucionit në funksion të zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese, duke i orientuar të trajnuarit në kuptimin e përgjegjësi të tyre teknike, profesionale në zbatim të legjislacionit fiskal.

2. OBJEKTIVI

- ❖ Krijimi i njohurive të reja dhe zgjerimi i njohurive ekzistuese rreth sistemit fiskal dhe ligjor nëpërmjet trajnimeve, duke krijuar mundësinë e shkëmbimit të njohurive mes kategorive të ndryshme të punonjësve teorik të Administratës Tatimore dhe Doganore, aftësimin e tyre praktik dhe teorik.
- ❖ Organizimi i trajnimeve në mënyrë efektive dhe eficiente duke mbajtur një kosto sa më të ulët por duke bërë të mundur zhvillimin cilësor të mësimdhënies.
- ❖ Orientimi i lektorëve dhe organizimi i workshopeve drejt seminarëve praktike duke zbatuar parimet e reja të mësimdhënies për të rriturit.
- ❖ QTATD siguron formimin profesional të administratës tatimore dhe doganore, i cili përfshin trajnimin:
 - në periudhën e provës
 - për zhvillimin e karrierës
 - për përshtatje profesionale, në rastet e ndryshimit të kërkesave të vendit të punës, sipas ligjeve të fushës
 - me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta

3. PËRMBLEDHJE

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore gjatë vitit 2020 është fokusuar në trajnimin fillestar dhe vazhdues të punonjësve të administratës tatimore dhe doganore, për çështje bazë, specifike, dhe ndryshime ligjore të fushës fiskale sipas kërkesave të veçanta të administratës fiskale, për punonjësit të punësuar nga programi i ekselencës, për nivelin drejtues dhe më vonë

edhe niveli drejtues si dhe punonjësit e tjerë civil të fiskut, në funksion të zhvillimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore të këtyre administratave.

Përzgjedhja e temave të trajnimit mbështetet në kërkesat e administratave fiskale, në bazë të identifikimit që ato i bëjnë nevojave për trajnim në tema dhe njerëz, ashtu si përcaktohet dhe në legjislacionin e qendrës. Temat e trajnimit zgjidhen në funksion të rritjes së kapaciteteve administrative të afta për të absorbuar reformat, për të kuptuar dhe zbatuar çdo ndryshim si në administrim ashtu dhe në teknikat ligjore, me qëllimin maksimizimin e të ardhurave, duke i shërbyer sa më mirë tatimpaguesve dhe me kosto sa më të ulët administrative.

Lektorët përzgjidhen duke zbatuar kriteret e vendosura nga qendra e trajnimit sipas VKM nr. 1264/2009, “Për krijimin dhe funksionimin e QTATD” dhe vendimit të bordit nr.2 datë 17.04.2019.

Në zbatim të Programit të Trajnimeve janë hartuar Kalendarët e Trajnimeve për sigurimin e duhur profesional të punonjësve të administratës tatimore dhe doganore.

Qendra vazhdimisht i planifikon veprimtaritë e saj bazuar në filozofinë e zhvillimit ose përmirësimit profesional gjatë të punuarit të cilësive profesionale që kanë të bëjnë me efektivitetin në punë si dhe të cilësive profesionale që kanë të bëjnë me detyrat e përditshme të vendit të punës.

Inspektorëve të tatimeve dhe doganave ju jepet mundësia e zhvillimit profesional pa pagesë gjatë trajnimeve me shpëputje nga puna në sallë ose pa shpëputje nga puna në vendin e punës nëpërmjet leksioneve me shkrim dhe gojë, të përgatitura nga një nivel i lartë profesional lektorësh dhe që varion gjerësisht në lidhje me filozofinë, përmbajtjen dhe formatin e eksperiencave të të mësuarit ose online.

Qendra përdor metodat profesionale të edukimit profesional të tilla si:

- ***Diskutime të rasteve praktike*** - me qëllim që inspektorët të vihen në rolin e vendim marrësit që përballlet me një problem. Çdo seminar është shoqëruar me një haësirë dedikuar rasteve praktike për ta bërë akoma më të prekshëm çdo problematikë sidomos duke pasur parasysh faktin që gjatë tre mujorit të para Qendra bën trajnimin e punonjësve të rinj të cilët nuk kanë eksperiencë.

- **Përdorim i trajnerëve nga radhët e metodistëve ose stafit drejtues të organeve fiskale** - me qëllim përmirësimin e kompetencave të pjesëmarrësve në një fushë specifike, nëpërmjet demonstrimit të procesit të observimit, reflektimit dhe veprimit.
- **Diskutim të çështjeve praktike të hasura nga vetë pjesëmarrësit** - me qëllim përmirësimin e praktikës profesionale, nëpërmjet angazhimit në ndarjen e çështjeve që shqetësojnë, me njëri tjetrin si dhe mësimin me kolegët me të cilët kanë të njëjtin objektiv për të arritur.
- **Leksione studimore** - me qëllim që të zgjidhen dilemat lidhur me mënyrën e leximit dhe interpretimit të neneve të veçanta të ligjeve fiskale.
- **Konsultime** – për të promovuar ndërgjegjësimin e inspektoreve dhe përpunimin e zhvillimit të tyre profesional nëpërmjet ofrimit dhe rekomandimit të mundësive të strukturuar për reflektim dhe observim.
- **Mbikqyrje reflektive** - për të mbështetur, zhvilluar dhe vlerësuar punën e lektorëve dhe performancën e pjesëmarrësve nëpërmjet një procesi pyetësorësh që inkurajon të kuptuarin dhe artikullimin e të arsyeshmes gjatë mësimdhënies dhe mësimarrjes.
- **Asistencë teknike** - për të ndihmuar individët e organeve fiskale të përmirësohen, nëpërmjet ofrimit të informacioneve dhe burimeve të legjislacionit primar e sekondar, udhëzuesëve e manualeve sipas punës që mbulon secili dhe detyrave në përputhje me punën.
- **Testime** – për të skanuar shkallën e njohurive që zotërojnë, njohurive që marrin dhe për të vlerësuar nevojat e mëtejshme për trajnim specifik.

QTATD është përpjekur të jetë sa më efiçente dhe efektive dhe në këtë kuadër ka përqafuar dhe përirjen e shekullit për rritjen e zhvillimit profesional të kryer online.

Në industrinë e edukimit, përdorimi i burimeve online të edukimit profesional përfaqëson një përqindje në rritje dhe QTATD kërkon ta përqafojë këtë risi duke respektuar gjithmonë faktin që shumë dije profesionale duhet të mbeten atribut vetëm i administratës (psh metodat e kontrollit, investigimit, etj) por dhe nevojën për trajnim të një mase më të gjerë profesionistësh që merren me çështjet tatimore dhe doganore jashtë administratës, të cilët është e pamundur ti trajnosh tërësisht

në salla për shkak të kostove dhe detyrimit parësor që ka qendra për trajnimin e organeve shtetërore.

Gjithashtu, QTATD po bashkëpunon me OECD, për ofrimin e mbështetjes në zhvillimin e kapaciteteve të fiskut nëpërmjet E-Learning.

Duke u gjendur edhe përballë situatës së COVID 19, kjo prirje e re e mësimdhënies e përqafuar nga kultura të vendeve nga e gjithë bota, është mënyra më efektive e të zhvilluarit seminarëve duke qenë gjithmonë në kontakt dhe koherencë me ligjet tatimore.

Të gjithë kalendarët u ribënë në mënyrë të tillë që të zhvilloheshin trajnimet online dhe kjo kërkoi kohë shtesë si dhe trajnime shtesë për personelin e brendshëm dhe lektorët e pjesmarrësit.

4. ORGANIZIMI DHE METODOLOGJIA

Orientimi i lektorëve dhe organizimi i workshopeve drejt seminarëve praktike duke zbatuar parimet e reja të mësimdhënies për të rriturit.

- ✓ Janë **trajnuar trajnerët rreth metodave të reja të mësimdhënies për të rritur** që kanë në qendër nxënësit dhe ku shkolla është instrument në avancimin dhe shpërndarjen e praktikave më të mira.
- ✓ Janë **trajnuar trajnerët mbi mësimdhënien në platforma online** dhe pjesmarrësit mbi aksesimin në këto platforma. Nëpërmjet organizimit të trajnimeve online **janë adaptuar** këto forma të reja të mësimdhënies.

Në kuadër të realizimit në mënyrë sa më efektive si dhe për të shmangur problematika të ndryshme teknike, nga specialistët e programeve u zhvillua një trajnim për trajnerët mbi përdorimin e platformës online zoom, opsionet që kjo platformë ofron si edhe u diskutua me ta mbi mënyrën e organizimit të seminarëve online.

Pjesa e mbetur e trajnimeve për nivelin drejtues u zhvillua online, ndërkohë ka filluar edhe zbatimin e kalendarëve për nivelin vazhdues.

5. AKTIVITETE TRAJNUESE


ADMINISTRATA TATIMORE

PUNONJËSIT E RINJ TË ADMINISTRATËS TATIMORE

➤ **AKTIVITET I**

Në datë **17.02.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë “**Administrata Tatimore Shqiptare, Organizimi, Funkzioni, Marrëdhëniet e punës, Kodi i Etikës dhe Shmangie e Konfliktit të Interesit, Procedurat e Vlerësimit të Performancës dhe Procedimi Disiplinor**” në QTATD

Ky trajnim si pjesë e paketës bazë për punonjësit e rinj të administratës tatimore, u zhvillua **1 ditë, me 6 orë** në përbërje ku morën pjesë **28 punonjës** të administratës tatimore, nga të cilët inspektorë nga kontrolli në zyrë, specialistë nga sektori i mbledhjes së borxhit, inspektorë hetimi, përgjegjës për sektorin e apelimit tatimor, specialistë hetimi por edhe punonjës me kontratë nga këto sektorë të cilët ndoqën trajnimin bazë mbi punonjësit e rinj ekselentë të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.



➤ **AKTIVITET II**

Në datë **18.02.2020 - 19.02.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë - Parimet e Administrimit Tatimor”** në QTATD.

Ky trajnim si pjesë e paketës bazë për punonjësit e rinj të administratës tatimore, u zhvillua **dy ditë, me 12 orë** në përbërje ku morën pjesë **29 punonjës** të administratës tatimore, nga të cilët inspektorë nga kontrolli në zyrë, specialistë nga sektori i mbledhjes së borxhit, inspektorë hetimi, përgjegjës për sektorin e apelimit tatimor, specialistë hetimi por edhe punonjës me kontratë nga këto sektorë të cilët ndoqën trajnimin bazë mbi punonjësit e rinj ekselentë të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.

➤ **AKTIVITET III**

Në datë **20.02.2020 - 21.02.2020 2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Bazat e tatimit mbi vlerën e shtuar - kuptimi i përgjithshëm dhe shpjegime bazë për njohjen e ligjit përkatës”** në QTATD.

Ky trajnim si pjesë e paketës bazë për punonjësit e rinj të administratës tatimore, u zhvillua **dy ditë, me 12 orë** në përbërje ku morën pjesë **28 punonjës** të administratës tatimore, nga të cilët inspektorë nga kontrolli në zyrë, specialistë nga sektori i mbledhjes së borxhit, inspektorë hetimi, përgjegjës për sektorin e apelimit tatimor, specialistë hetimi por edhe punonjës me kontratë nga këto sektorë të cilët ndoqën trajnimin bazë mbi punonjësit e rinj ekselentë të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.

➤ **AKTIVITET IV**

Në datë **24.02.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Standartet e kontabilitetit dhe njohuri bazë mbi kontrollin tatimor”** në QTATD.

Ky trajnim si pjesë e paketës bazë për punonjësit e rinj të administratës tatimore, u zhvillua **një ditë, me 6 orë** në përbërje, ku morën pjesë **28 punonjës** të administratës tatimore, nga të cilët

inspektorë nga kontrolli në zyrë, specialistë nga sektori i mbledhjes së borxhit, inspektorë hetimi, përgjegjës për sektorin e apelimit tatimor, specialistë hetimi por edhe punonjës me kontratë nga këto sektorë të cilët ndoqën trajnimin bazë mbi punonjësit e rinj ekselentë të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.

➤ **AKTIVITET V**

Në datë **25.02.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Bazat e tatimit mbi të ardhurat personale”** në QTATD.

Ky trajnim si pjesë e paketës bazë për punonjësit e rinj të administratës tatimore, u zhvillua **një ditë, me 6 orë** në përbërje ku morën pjesë **29 punonjës** të administratës tatimore, nga të cilët inspektorë nga kontrolli në zyrë, specialistë nga sektori i mbledhjes së borxhit, inspektorë hetimi, përgjegjës për sektorin e apelimit tatimor, specialistë hetimi por edhe punonjës me kontratë nga këto sektorë të cilët ndoqën trajnimin bazë mbi punonjësit e rinj ekselentë të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.

➤ **AKTIVITET VI**

Në datë **26.02.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Bazat e tatimit mbi të ardhurat e kompanive”** në QTATD.

Ky trajnim si pjesë e paketës bazë për punonjësit e rinj të administratës tatimore, u zhvillua **një ditë, me 6 orë** në përbërje ku morën pjesë **29 punonjës** të administratës tatimore, nga të cilët inspektorë nga kontrolli në zyrë, specialistë nga sektori i mbledhjes së borxhit, inspektorë hetimi, përgjegjës për sektorin e apelimit tatimor, specialistë hetimi por edhe punonjës me kontratë nga këto sektorë të cilët ndoqën trajnimin bazë mbi punonjësit e rinj ekselentë të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.

➤ **AKTIVITET VII**

Në datë **27.02.2020 – 02.03.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Manualet e vlerësimit, borxhit, shërbimit, hetimit”** në QTATD.

Ky trajnim si pjesë e paketës bazë për punonjësit e rinj të administratës tatimore, u zhvillua **dy ditë, me 12 orë** në përbërje ku morën pjesë **28 punonjës** të administratës tatimore, nga të cilët inspektorë nga kontrolli në zyrë, specialistë nga sektori i mbledhjes së borxhit, inspektorë hetimi, përgjegjës për sektorin e apelimit tatimor, specialistë hetimi por edhe punonjës me kontratë nga këto sektorë të cilët ndoqën trajnimin bazë mbi punonjësit e rinj ekselentë të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.

➤ **AKTIVITET VIII**

Në datë **28.02.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Njohuri bazë për legjislacionin e taksave nacionale dhe lokale”** në QTATD.

Ky trajnim si pjesë e paketës bazë për punonjësit e rinj të administratës tatimore, u zhvillua **një ditë, me 6 orë** në përbërje, ku morën pjesë **27 punonjës** të administratës tatimore, nga të cilët inspektorë nga kontrolli në zyrë, specialistë nga sektori i mbledhjes së borxhit, inspektorë hetimi, përgjegjës për sektorin e apelimit tatimor, specialistë hetimi por edhe punonjës me kontratë nga këto sektorë të cilët ndoqën trajnimin bazë mbi punonjësit e rinj ekselentë të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.

➤ **AKTIVITET IX**

Në datë **03.03.2020 2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Njohuri bazë për ligjin për Faturën dhe Monitorimin e Qarkullimit. (fiskalizimit), C@ts”** në QTATD.

Ky trajnim si pjesë e paketës bazë për punonjësit e rinj të administratës tatimore, u zhvillua **dy ditë, me 12 orë** në përbërje ku morën pjesë **27 punonjës** të administratës tatimore, nga të cilët inspektorë nga kontrolli në zyrë, specialistë nga sektori i mbledhjes së borxhit, inspektorë hetimi,

përgjegjës për sektorin e apelimit tatimor, specialistë hetimi por edhe punonjës me kontratë nga këto sektorë të cilët ndoqën trajnimin bazë mbi punonjësit e rinj ekselentë të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.

➤ **AKTIVITET X**

TESTIMI DHE CERTIFIKIMI I PUNONJËSVE EKSELENTË DHE PUNONJËSVE TË RINJ NË PERIUDHË PROVE

Në zbatim të programit të trajnimeve të Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore për vitin 2020, miratuar me Vendimin e Bordit të QTATD Nr. 1 Datë 21.01.2020, është zhvilluar programi i trajnimit bazë për punonjësit ekselentë dhe punonjësit e rinj të Administratës Tatimore, nga data 17.02.2020 deri në datë 03.03.2020 pranë sallës së Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore.

Në përfundim të trajnimit është zhvilluar testimi **në datë 24.09.2020** mbi temat e trajnimit i cili për shkak të situatës së krijuar prej pandemisë u zhvillua në përputhje të plotë me masat e nevojshme në kuadër të parandalimit të përhapjes së Covid 19.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin gjithsej 29 punonjës të cilët për shkak të ruajtjes së distancës si një nga masat ndaj parandalimit të përhapjes së Covid 19, u ndanë në tre grupe me nga 10 persona dhe e zhvilluan testimin në tre orare të ndryshme sipas grupeve respektive.

U certifikuan të gjithë punonjësit të cilët përfunduan me sukses trajnimin bazë për punonjësit e rinj dhe testimin mbi njohuritë e marra sipas modelit të miratuar në Bordin QTATD.

PUNONJËSIT E NIVELIT DREJTUES TË ADMINISTRATËS TATIMORE

➤ **AKTIVITET XI**

Në datë **04.03.2020 – 05.03.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Ligji i Procedurave Tatimore”** në QTATD.

Ky trajnim si pjesë e paketës bazë për punonjësit e rinj të administratës tatimore, u zhvillua **dy ditë, me 12 orë** në përbërje, ku morën pjesë **26 punonjës** të nivelit drejtues të cilët po ndjekin paketën e trajnimeve për nivelin e mesëm dhe të lartë drejtues miratuar nga **Bordi i QTATD**.

Në mbështetje të masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid 19 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me anë të urdhrin nr. 132 datë 08.03.2020 ndryshuar me urdhrin nr 222 datë 01.04.2020, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në kuadër të zbatimit të programeve të trajnimit, ka vendosur zhvillimin e trajnimeve online.

Platformat e zgjedhura për zhvillimin e këtyre seminarëve online janë platforma zoom dhe Google Classroom.

Në kuadër të realizimit në mënyrë sa më efektive si dhe për të shmangur problematika të ndryshme teknike, nga specialistët e programeve është zhvilluar një trajnim për trajnerët mbi përdorimin e platformës Zoom, opsionet që kjo platformë ofron si edhe u diskutua me ta mbi mënyrën e organizimit të seminarëve.

Mënyra e zhvillimit të këtyre seminarëve është interaktive ku pjesëmarrësit nëpërmjet chatit të lënë në dispozicion, ose opsionit raise hand mund të bënin pyetje apo të diskutonin mbi çështje të ndryshme praktike pasi edhe vetë QTATD e ka orientuar mënyrën e zhvillimit të seminarëve çdo herë e më shumë drejt rasteve praktike.

Në platformën Google Classroom janë krijuar klasat onine sipas temave në përputhje me programin e trajnimit për nivelin drejtues, ku janë vendosur kurrikulat përkatëse, janë përfshirë pjesëmarrësit si edhe lektorët në mënyrë që diskutimet të ishin të dukshme për të gjithë.

➤ **AKTIVITET XII**

Në datë **12.05.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Tatimi mbi të ardhurat”** online.

Ky trajnim u zhvillua në një ditë, me 2 Seanca Zoom në përbërje ku morën pjesë **12 punonjës** të nivelit drejtues të cilët po ndjekin paketën e trajnimeve për nivelin e mesëm dhe të lartë drejtues të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.

➤ **AKTIVITET XIII**

Në datë **13.05.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“TVSH. Ligji për Faturën dhe Monitorimin e Qarkullimit”** online.

Ky trajnim u zhvillua në një ditë, me 2 Seanca Zoom në përbërje ku morën pjesë **13 punonjës** të nivelit drejtues të cilët po ndjekin paketën e trajnimeve për nivelin e mesëm dhe të lartë drejtues të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.

➤ **AKTIVITET XIV**

Në datë **14.05.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Sistemi C@ts”** online.

Ky trajnim u zhvillua në një ditë, me 2 Seanca Zoom në përbërje ku morën pjesë **9 punonjës** të nivelit drejtues të cilët po ndjekin paketën e trajnimeve për nivelin e mesëm dhe të lartë drejtues të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.

➤ **AKTIVITET XV**

Në datë **15.05.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Manualet e vlerësimit, borxhit, shërbimit, hetimit.”** online.

Ky trajnim u zhvillua në një ditë, me 2 Seanca Zoom në përbërje ku morën pjesë **13 punonjës** të nivelit drejtues të cilët po ndjekin paketën e trajnimeve për nivelin e mesëm dhe të lartë drejtues të administratës tatimore miratuar nga Bordi i QTATD.

PUNONJËSIT E NIVELIT VAZHDUES TË ADMINISTRATËS TATIMORE

➤ **AKTIVITET XVI**

Në datë **20.05.2020 – 21.05.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Ligji për**

Faturën dhe Monitorimin e Qarkullimit. Ndryshimet në legjislacionin tatimor në funksion të këtij ligji” online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 seanca** trajnimi ku morën pjesë **43 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektor kontrolli operacional, inspektor risku, përgjegjës i sektorit të shërbimit të tatimpaguesit, specialist shërbimi, inspektore kontrolli, përgjegjës shërbimi, inspektor kontrolli nga zyra.

➤ **AKTIVITET XVII**

Në datë **27.05.2020 – 28.05.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Ndryshimet në paketën fiskale”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 3 seanca** trajnimi ku morën pjesë **44 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektor kontrolli operacional, inspektor risku, përgjegjës i sektorit të shërbimit të tatimpaguesit, specialist shërbimi, inspektore kontrolli, përgjegjës shërbimi, inspektor kontrolli nga zyra.

➤ **AKTIVITET XVIII**

Në datë **10.06.2020 – 11.06.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Sistemi tatimor- Procedurat tatimore II”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 3 seanca trajnimi**, ku morën pjesë **29 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektor kontrolli operacional, specialist shërbimi, inspektor kontrolli nga zyra, specialist sektori juridik.

➤ **AKTIVITET XIX**

Në datë **17.06.2020 – 18.06.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Sistemi tatimor- Procedurat tatimore III”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 seanca** trajnimi ku morën pjesë **54 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektor kontrolli operacional, specialist shërbimi, inspektor kontrolli nga zyra, specialist sektori juridik.

➤ **AKTIVITET XX**

Në datë **24.06.2020 – 25.06.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Sistemi tatimor- Procedurat tatimore IV”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 seanca** trajnimi ku morën pjesë **40 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektor i sektorit të mbledhjes të detyrimeve të papaguara, specialist i sektorit të shërbimit të tatimpaguesve, specialist sektori i asistences dhe regjistrimit, specialist sektori i edukimit dhe marrëdhënieve me publikun.

➤ **AKTIVITET XXI**

Në datë **01.07.2020 – 02.07.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Tatimet indirekte: TVSH 1”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 seanca** trajnimi ku morën pjesë **30 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialist, specialist shërbimi.

➤ **AKTIVITET XXII**

Në datë **03.07.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Sistemi tatimor - Procedurat tatimore I”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në një ditë, në total 3 seanca** trajnimi ku morën pjesë **23 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialistë, specialistë shërbimi, specialist sektori juridik, inspektorë kontrolli operacional.

➤ **AKTIVITET XXIII**

Në datë **09.07.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë “**Tatimet indirekte: TVSH 1I**” online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në një ditë, në total 2 seanca** trajnimi ku morën pjesë **24 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialistë, specialistë shërbimi, specialistë tatimpaguesi.

➤ **AKTIVITET XXIV**

Në datë **16.07.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë “**Tatimet indirekte: TVSH 1II**” online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në një ditë, në total 2 seanca** trajnimi ku morën pjesë **29 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialistë, specialistë shërbimi, specialistë tatimpaguesi.

➤ **AKTIVITET XXV**

Në datë **17.09.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë “**Tatimet indirekte: TVSH 1V**” online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në një ditë, në total 2 seanca** trajnimi ku morën pjesë **31 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialistë, specialistë shërbimi, specialistë tatimpaguesi.

➤ **AKTIVITET XXVI**

Në datë **23.09.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë “**Tatimi mbi të ardhurat I**” online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në një ditë, në total 3 seanca** trajnimi ku morën pjesë **21 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialistë, specialistë shërbimi, specialistë tatimpaguesi, inspektor i mbledhjes së detyrimeve.



➤ **AKTIVITET XXVII**

Në datë **30.09.2020 – 01.10.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Tatimi mbi të ardhurat II”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 seanca** trajnimi ku morën pjesë **35 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialistë, specialistë shërbimi, specialistë tatimpaguesi, inspektor i mbledhjes së detyrimeve, inspektor kontabiliteti, sektori i kontrollit nga zyra dhe monitorimit.

➤ **AKTIVITET XXVIII**

Në datë **05.11. 2020 – 09.11.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Tatimi mbi fitimin I”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 seanca** trajnimi ku morën pjesë **33 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialist e regjistrimit, inspektor kontabiliteti, sektori i kontrollit nga zyra dhe monitorimit.

➤ **AKTIVITET XXIX**

Në datë **12.11. 2020 – 13.11.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Tatimi mbi fitimin II”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 seanca** trajnimi ku morën pjesë **24 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialist e regjistrimit, inspektor kontabiliteti, sektori i kontrollit nga zyra dhe monitorimit.

➤ **AKTIVITET XXX**

Në datë **19.11. 2020 – 20.11.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Transferimi i çmimit”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 3 seanca** trajnimi ku morën pjesë **22 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialist e regjistrimit, inspektor kontabiliteti, sektori i kontrollit nga zyra dhe monitorimit.

➤ **AKTIVITET XXXI**

Në datë **23.11. 2020 – 24.11.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Apelimi Tatimor”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 seanca** trajnimi ku morën pjesë **23 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialiste regjistrimit, inspektor kontabiliteti, sektori i kontrollit nga zyra dhe monitorimit, inspektorë të dytë.

➤ **AKTIVITET XXXII**

Në datë **02.12.2020 – 03.12.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë “**Taksat Lokale**” online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 seanca** trajnimi ku morën pjesë **17 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialiste regjistrimit, inspektor kontabiliteti, sektori i kontrollit nga zyra dhe monitorimit, inspektorë të dytë, inspektorë Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave.

➤ **AKTIVITET XXXIII**

Në datë **02.12.2020 – 03.12.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë “**Çështje gjyqësore në fushën tatimore**” online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 seanca** trajnimi ku morën pjesë **23 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialiste regjistrimit, inspektor kontabiliteti, sektori i kontrollit nga zyra dhe monitorimit, inspektorë të dytë, inspektorë Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, jurist, specialist në zyrën juridike.

➤ **AKTIVITET XXXIV**

Në datë **07.12.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë “**Kontabiliteti**” online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në një ditë, në total 2 seanca** trajnimi ku morën pjesë **16 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë hetimi, inspektorë kontabiliteti, inspektorë të dytë, inspektorë Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, jurist, specialist në zyrën juridike.

➤ **AKTIVITET XXXV**

Në datë **10.12.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë “**Hetimi Tatimor**” online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në një ditë, në total 2 seanca** trajnimi ku morën pjesë **19 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë hetimi, inspektorë të dytë, inspektorë Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, jurist, specialistë në zyrën juridike.

➤ **AKTIVITET XXXVI**

Në datë **14.12.2020 – 15.12.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Çështje gjyqësore në fushën e tatimeve dhe doganave”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 seanca** trajnimi ku morën pjesë **24 punonjës** të nivelit vazhdues i administratës tatimore me pozicione si inspektorë, inspektorë kontrolli, specialiste regjistrimit, inspektor kontabiliteti, sektori i kontrollit nga zyra dhe monitorimit, inspektorë të dytë, inspektorë Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, jurist, specialist në zyrën juridike, specialiste.

PUNONJËSIT E RINJ TË STRUKTURËS SË HETIMIT TATIMOR TË ADMINISTRATËS TATIMORE

➤ **AKTIVITET XXXVII**

Në datë **12.10.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Njohuri bazë mbi Administratën Publike, Kodin e Etikës dhe marrëdhëniet e punës”** në sallën QTATD.

Ky trajnim u zhvillua **në një ditë, në 4 orë trajnimi** ku morën pjesë punonjësit e rinj të strukturës së hetimit tatimor të administratës tatimore.

➤ **AKTIVITET XXXVIII**

Në datë **13.10.2020 – 14.10.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”** në sallë dhe online.

Ky trajnim u zhvillua në sallë dhe në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 orë trajnimi në sallë dhe 2 seanca trajnimi online** ku morën pjesë punonjësit e rinj të strukturës së hetimit tatimor të administrates tatimore.

➤ **AKTIVITET XXXIX**

Në datë **15.10.2020 – 16.10.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Njohuri bazë për legjislacionin tatimor dhe të ligjeve të veçanta në përbërje të tij”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në dy ditë, në total 4 seanca trajnimi** online ku morën pjesë punonjësit e rinj të strukturës së hetimit tatimor të administrates tatimore.

➤ **AKTIVITET XXXX**

Në datë **19.10.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Njohuri bazë mbi Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe të vlerësimit të veprave penale në fushën tatimore”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në një ditë, në total 2 seanca trajnimi** online ku morën pjesë punonjësit e rinj të strukturës së hetimit tatimor të administrates tatimore.

➤ **AKTIVITET XXXXI**

Në datë **21.10.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Njohuri në fushën e IT-së, për qëllime hetimore”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në një ditë, në total 2 seanca trajnimi** online ku morën pjesë punonjësit e rinj të strukturës së hetimit tatimor të administrates tatimore.

➤ **AKTIVITET XXXXII**

Në datë **22.10.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Njohuri bazë për sistemin C@TS.”** online.



Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në një ditë, në total 2 seanca trajnimi** online ku morën pjesë punonjësit e rinj të strukturës së hetimit tatimor të administrates tatimore.

➤ **AKTIVITET XXXXIII**

Në datë **23.10.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Të tjera njohuri bazë që lidhen me fushën e hetimit të krimit tatimor”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në një ditë, në total 2 seanca trajnimi** online ku morën pjesë punonjësit e rinj të strukturës së hetimit tatimor të administrates tatimore.

➤ **AKTIVITET XXXXIV**

Në datë **27.10.2020** Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve zhvilloi trajnimin me temë **“Njohuri bazë mbi procedurat e hetimit tatimor, për zbulimin, parandalimin e luftën kundër krimit tatimor”** online.

Ky trajnim u zhvillua në platformën online Zoom, **në një ditë ditë, në total 2 seanca trajnimi** online ku morën pjesë punonjësit e rinj të strukturës së hetimit tatimor të administrates tatimore.

➤ **AKTIVITET XXXXV**

TESTIMI DHE CERTIFIKIMI I PUNONJËSVE TË RINJ TË STRUKTURËS SË HETIMIT TATIMOR

